



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:182666
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05763906

Ac.nr.421/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit I.R. nga fshati, Komuna e Klinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” në Pejë, kundër të paditurës: Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.K. dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson M.K., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës së parë dhe të paditurës së dytë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë, C.nr.272/16 te datës 19.12.2019, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë, C.nr.272/16 i datës 19.12.2019, në pikën I dhe II, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial për paditësin si dhe në pikën III, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë për kamatën, VËRTETOHET.

II. PRANOHET pjesërisht ankesa e të paditurës BKS Prishtinë dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë, C.nr.272/16 i datës 19.12.2019, në pikën III, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë për shpenzimet e procedurës dhe gjykohet si në vijim: DETYROHEN

të paditurat BKS dhe Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës konstestimore mbi bazën e përgjegjësisë së ndarë, paditësit t’i paguajnë shumën në lartësi prej 1.568€, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës për shpenzimet e procedurës, përtej shumës së gjykuar, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën IV dhe V, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.272/16, të datës 19.12.2019, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur të aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.R. nga fshatiKomuna e Klinës. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohen të paditurat Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë dhe Kompania e Sigurimit “S...”, me seli në Prishtinë që paditësit në emër të demit jo-material dhe material, në mënyrë solidare sipas përgjegjësisë dhe të kontributit 70% të paditurës së parë dhe 30% të paditurës së dytë t’ia paguajnë shumat dhe atë: Në emër të demit jomaterial, për dhimbjet e përjetuar fizike shumën prej 900.00 €, - për frikë të përjetuar shumën prej 800.00€, - për 250.00€; II. Në emër të demit material; për shpenzimet e mjekimit shumën prej 48€, Në emër të demit material të shkaktuar në veturën VW-.....t’ia paguaj shumën prej 1.260 euro. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të detyrohen të paditurat Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë dhe Kompania e Sigurimit “S...”, me seli në Prishtinë që paditësit shumat e gjykuara prej 3,258 euro të specifikuara si në pikën I, dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të demit jo material dhe për dem material t’ia paguaj me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dt.18.12.2019 ,e gjer në pagesën definitive si shpenzimet procedurale në lartësi prej 2513 euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit.

Në pikën IV të dispozitivit refuzohet kërkesëpadia e paditësit I.R. nga fshati, Komuna e Klinës, përtej shumës së gjykuar si në pikën I dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për aksidentin e dt.04.07.2016, për shumat e specifikuara në emër të demit jo material: - për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 3.100€; - për frikën e përjetuar shumën prej 2200€; Në emër të demit material: - Për ndihmë dhe kujdes të huaj 150.00euro, Për ushqim të përforcuar 150.00euro. Në pikën V, të dispozitivit ka vendosur të refuzohet kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që për shumat e gjykuara si në pikën I dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi t’i paguaj prestimet me interes për vonesë në lartësi prej 12% të interesit vjetor, e cila llogaritet për çdo ditë vonesë deri pagesën e dëmshpërblimit nga e paditura duke filluar nga data e parashtrimit të padisë për dëmshpërblim e deri në pagesën definitive dhe për shpenzime procedurale përtej shumës së aprovuar.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës së parë BKS Prishtinë në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj dhe shumat e gjykuara t’i gjykojë dukshëm më të ulta, apo aktgjykimin ta prish dhe lëndën t’ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës së dytë në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim

që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat janë pjesërisht të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datë 20.09.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, kundër të paditurave, të zgjeruar në kuptimin subjektiv me parashtrësën e datës 22.07.2019, me të cilën ka kërkuar që të: Miratohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit I.R. nga fshati....., Komuna e Klinës dhe Detyrohen të paditurat Byroja Kosovare e Sigurimit BKS “Lidhja e Pejës” nr. 15, dhe Kompania e Sigurimeve “S...”, rr. “....” 10.000 Prishtinë, që në emër të zhdëmtimit jomaterial sipas fatkeqësisë së komunikacionit rrugor të shkaktuar me datën 04.07.2016, nga baza e auto përgjegjësisë, paditësit në mënyrë solidare t'ia paguajnë shumën prej 19.500 € dhe atë për: dhimbje fizike shumën prej 5.000€, dhimbje të përjetuara shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 10.000€, shëmtim trupor shumën prej 500 €, frikën e përjetuar shumën prej 2.000€, II. Detyrohen të paditurat që në emër të dëmit material që ka të bëjë me ndihmën dhe kujdesin e huaj, ushqimin e përforcuar dhe shpenzimet e mjekimit solidarisht t'ia paguajnë paditësit shumën prej 1.150 € dhe atë për: ndihmë dhe kujdes të huaj shumën prej 450 €, ushqim të përforcuar shumën prej 500 € dhe shpenzimet e mjekimit shumën prej 200 €. Prestimet nga pika I dhe II, e dispozitivit të këtij aktgjykimi detyrohen të paditurat që solidarisht ti përmbushin ndaj paditësit dhe atë me kamatë 12 % të interesit vjetor, duke llogaritur për çdo ditë vonese e deri në pagesën definitive nga të paditurat, III. Detyrohen të paditurat që paditësit në emër të dëmit material në veturë t'ia paguajnë shumën prej 2.000 €, IV, krejt këtë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.272/16, të datës 19.12.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se nga provat e administruara ka konstatuar që me dt....., rreth orës në fshatin... , K. Klinë ku në qarkullim ishin të përfshirë, katër automjete Ku gjer te aksidenti kishte ardhur në atë mënyrë drejtuesi i automjetit A (me polisë të sigurimit kufitar), duke mos iu përshtatur kushteve të rrugës dhe shpejtësisë dhe nga pakujdesia e kishte lëshuar shiritin e djathtë të lëvizës duke kaluar në shiritin e majtë lëvizës, kështu që me veprimin e tij kishte ndërprerë rrugën në një distancë të shkurtër, ashtu qe automjeti B të cilin e drejtonte këtu paditësi, në pamundësi të ndaljes me pjesën e parë të automjetit e kishte goditur automjetin A. Automjeti B pastaj nga prapa goditet nga automjeti C,(i siguruar te e paditura e dytë) dhe si pasojë e kësaj drejtuesi i automjetit B kishte marr lëndime trupore dhe ishte dërguar në spitalin rajonal Pejë. Gjykata ka shtuar se baza e kërkesëpadiisë që të paditurat të jenë përgjegjëse për të kompensuar paditësin gjen mbështetje në provat shkresore si: ekspertiza e komunikacionit të dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë e dt.03.10.2016; dhe ekspertiza e komunikacionit e dt.25.05.2019 të nxjerr nga eksperti S.B. dhe në dispozitat e nenit 179,177,183 dhe nenit 358 të LMD-së,

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit jomaterial dhe material, gjykata e shkallës së parë në cilësinë të provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Vjollca Binçe ortoped - traumatolog dhe Valbonë Blakaj - Ramadani psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional Tëdatës 26.11.2019, kanë konstatuar se: Padiësi Isni Racaj, si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar lëndime trupore dhe atë: ndrydhje të kokës dhe qafës, gërvishtje të regjionit të kokës, hematomë përreth syrit të majtë, përdredhje e qafës, ndrydhjes të gjoksit dhe plagë shqyrëse në regjionin e gjurit të majtë, të cilat lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve, padiësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe atë: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 40 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 18 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 1 muaj. Si pasojë e këtij aksidenti, padiësi ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekonda, frikë sekondare me intensitet të lartë në kohëzgjatje prej 48 orë, frikë sekondare me intensitet të mesëm 8 javë dhe frikë sekondare me intensitet të ulët vazhdon ende edhe sot e kësaj dite. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka pasur. Shëmtimi trupor i shkallës së lehtë për shkak të vrazës së mbetur pas intervenimit kirurgjikal në regjionin e gjurit të djathtë në gjatësi prej 3 cm, Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 15 ditësh. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 2 javë. Rehabilitimi fizikal ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar neneve 136, 159, 177, 179, 183 paragraf 1 dhe 358 të LMD-së, lidhur me nenin 7 paragraf 1, 319 paragraf 1 dhe 322 paragraf 3 dhe 323 të LPK-së. Për kamatën ka vendosur në kuptim të nenit 382 paragraf 2 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe, Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesës së kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit, fillimisht mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në këtë rast përgjegjësia e të paditurave është e ndarë 70% për të paditurën e parë dhe 30 % për të paditurën e dytë. Këtë përfundim gjykata e ka mbështetur në provat e administruara e në veçanti në vlerësimin e ekspertit të Komunikacionit Rrugor, nga ku rezulton se: Përgjegjësia për 70%, e të paditurës së parë konsiston në faktin se drejtuesi i automjetit A ka kaluar përtej mesit të rrugës në shiritin që i takonte për lëvizjes automjetit B, ku si pasojë e shpejtësisë së papërshtatshme të lëvizjes dhe manovrimit të përshpejtuar duke u lakuar, ku sidomos gjatë rrugës së lagur humbja e kontrollit është shpeshherë prezentë. Përgjegjësia për 30%, e të paditurës së dytë konsiston në shpejtësi joadekuate sipas shenjave 50 km/h kushteve dhe rrethanave të krijuara në komunikacion. I njëjti po ashtu nuk ka mbajtur distancën e sigurisë dhe shpejtësisë së mjetit në atë mënyrë që mjetin ta ndalë para çdo pengese, por duke frenuar e

ka goditur automjetin B, dhe e ka zhvendosur për disa metra larg dhe me veprimet e tij i ka kontribuar rritjes së vëllimit të dëmeve në automjetin B.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat, përkatësisht faktet e rastit lidhur me kohën dhe vendin e aksidentit, automjetet e përfshira në të, shkaktarin, kontributin dhe pasojat e aksidentit. Për më shumë, nuk ishte kontestues që paditësi nga ky aksident, të cilit nuk i ka kontribuar, ka pësuar dëm jomaterial për shkak të lëndimeve të lehta trupore si dhe dëm material në automjet. Nuk ka qenë kontestues baza juridike e kërkesëpadisë ashtu siç kanë deklaruar të autorizuarit e të paditurave gjatë seancës së shqyrtimit kryesor. Në këtë rast të paditurat edhe pse e kanë kundërshtuar lartësinë e saj gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë të njëjtat me asnjë provë bindëse nuk kanë argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia edhe pse kanë pasur për detyrë ta bëjnë një gjë të tillë, në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që të paditurat të jenë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit gjen mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për paditësin për shpenzimet e mjekimit, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse baza juridike për këto kategori të dëmit gjen mbështetje në nenin 179 paragraf 1 të LMD-së. Në këtë rast paditësit si pasojë e aksidentit i janë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe lartësia e tyre është vërtetuar me prova dhe atë kuponët fiskal. të administruar si provë në seancën e shqyrtimit kryesor.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategorinë e dëmit material të shkaktuar në automjet në raport me paditësin, pasi që vlerësoi se shuma e gjykuar është vërtetuar në bazë të ekspertizës nga lëmia e makinerisë të datës 04.10.2019 e punuar nga eksperti S.B.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 19.12.2019, e deri në pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se të paditurat kanë rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Me referim në ankesën e të paditurave dhe në provat shkresore, Gjykata e Apelit e ndryshoi pjesën e aktgjykimit të atakuar sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, pasi ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë ka caktuar shumën më të lartë sesa ajo që përcaktohet në TOAK, marrë parasysh vlerën e kontestit për të cilin është zhvilluar procedura konkrete. Me këtë rast gjykata e shkallës së dytë konstaton se shpenzimet e procedurës kontestimore paraqiten në shumën prej 1.568 € dhe atë: për 6 seanca të mbajtura nga 135 € për secilën veç e veç, 810 €, 208 € për përpilimin e padisë, 300 € për ekspertiza mjekësore - ortopedin, 150 € për ekspertin mjekësor - psikiatrin 150€, për ekspertin e makinerisë - 150€ dhe 100€ për taksë gjyqësore për padi dhe prandaj nga arsyet e parashtruara vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pika IV dhe V, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, duke u mbështetur në nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e) e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.421/20, me datë 24.05.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli